



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	31.08.2026
REFERENC-Ë:	25/8603/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Vëllezërit e Bashkuar" SH.P.K. Zhur, Prizren Bazë e betonit dhe prodhimi i elementeve nga betoni në Vlashnje, Prizren.
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 25/8603/MMPH, datë 27.11.2025, të parashtruar nga operatori "Vëllezërit e Bashkuar" SH.P.K. Zhur, Prizren, për bazën e betonit dhe prodhimin e elementeve nga betoni në Vlashnje, Prizren.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore për operatorin "Vëllezërit e Bashkuar" SH.P.K. Zhur, Prizren, për bazën e betonit dhe prodhimin e elementeve nga betoni në Vlashnje, Prizren.

Me respekt!

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING

Njësia Org.
Org.Jedinica
Org.Unit DMV

Nr.Prot.
Broj.Prot.
Prot.No. 8603-2/25

Nr. i faqeve
Broj.stranica
No. pages -03-

Data.
Datum: 03, 09 / 20 26

PRISHTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the
General Secretary*

Nr.: 25/8603/MMPH
Datë: 31.08.2026


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit "Vëllezërit e Bashkuar" SH.P.K. Zhur, Prizren, i ndërpritet procedura administrative për me nr. prot. 25/8603/MMPH, datë: 27.11.2025, për bazën e betonit dhe prodhimin e elementeve nga betoni në pjesët e ngastrave kadastrale nr. P-71813006-00662-0, zona kadastrale Vlashnje, Prizren.

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për pajisje Leje Mjedisore me nr. prot. 25/8603/MMPH, datë: 27.11.2025, të operatorit "Vëllezërit e Bashkuar" SH.P.K. Zhur, Prizren, për bazën e betonit dhe prodhimin e elementeve nga betoni në Vlashnje, Prizren, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën administrativisht dhe në përputhje me



nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 10.07.2026 si në vijim:

- Lejen për aktivitete të veçanta për bazën e betonit nga KPMM me afat të vlefshmërisë.

Operatori nuk ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur me datë 25.08.2026, konstatoi se operatori "Vëllezërit e Bashkuar" SH.P.K. Zhur, Prizren, për bazën e betonit dhe prodhimin e elementeve nga betoni në Vlashnje, Prizren nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për Lejes Mjedisore, pasi qe nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur më lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.



Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.